

LURA TURHANI (KOBURJA)

**TERMI NJËFJALËSH DHE TERMI TOGFJALËSH NË TEKSTET
MËSIMORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (APU)**

Në FGjSh 2006 jepet ky shpjegim për termin: *term,-mi. sh.-a(t) 1. emërtim me një fjalë a me një togfjalësh i një koncepti në një fushë të shkencës, teknikës, të artit etj.* F. Leka në “Udhëzues për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore”, termin e shpjegon si “...një fjalë e posaçme që emërton një koncept a një send në një fushë të caktuar të shkencës, të teknikës a të prodhimit ose të një veprimtarie tjetër të kufizuar.”¹ Për H. Pashon, termi është “... fjalë ose togfjalësh (dhe jo vetëm fjalë)...”² A. Duro e përkufizon termin si “...njësi emërtuese speciale, që shpreh një koncept si element të një sistemi të organizuar të një fushe të caktuar të dijes.”³ Siç shihet shprehja e konceptit, emërtimi i tij, është elementi më i rëndësishëm e i përbashkët në përcaktimet që i janë bërë termit nga terminologët tanë. Struktura e tij njëfjalëshe apo togfjalëshe nuk është çështje e diskutuar: dallohet qartazi nga të gjithë studiuesit klasifikimi strukturor në term njëfjalësh e në term togfjalësh.

1. Termi njëfjalësh në tekstet mësimore të APU-së

Si njësi shënuese e mëvetësishme, qenësore për termin është shprehja e konceptit, pa bërë dallim: term njëfjalësh apo togfjalësh. Termat njëfjalësh përmbushin vetitë e termit: saktësinë, njëkuptimësinë, shkurtësinë dhe motivueshmërinë. Emërtimi i një koncepti me kufij kuptimorë të përcaktuar kushtëzon qartësi e motivueshmëri të termit. Sistemi terminologjik i teksteve mësimore, si pjesë e makrosistemit terminologjik tërësor, paraqitet në mënyrë sistimore, ashtu si dhe fusha e dijes së cilës i përket. Çdo njësi bazë e leksikut të specializuar, pra çdo term, është një koncept kyç në tekstet mësimore të APU. Në tekstet e arsimit parauniversitar, termi njëfjalësh, për arsye didaktike, është më i përdorshëm në klasat e ulëta sesa në klasat e larta: nxënësit përftojnë në mënyrë më të vetvetishme dhe më lehtë termin njëfjalësh në hapat e parë të formimit të tyre shkencor. Kjo gjë lidhet:

1. Me funksionin emërtues që përmbush termi njëfjalësh, dhe me shkurtësinë e tij;

2. Me vlerën përdorimore, vëllimin konceptor dhe ngarkesën konceptore të lartë që ato shpërfaqin. Kjo natyrë e termit shfrytëzohet në përdorimin e tyre sidomos në tekstet mësimore të klasave të ulëta të arsimit 9-vjeçar. Terma me

¹ F. Leka, *Udhëzues për përpunimin e terminologjisë*, Tiranë 1985, f. 5.

² H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 16.

³ A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 58.

ngarkesë të lartë konceptore dalin, p.sh., termat – emra, që janë edhe terma qendrorë për fushat përkatëse, si: *fjali, pikë, trup, energji, fushë, kënd, rrymë, mjedis, rrënjë* etj. Denduria e përdorimit të tyre lidhet me faktin se këto fjalë-terma paraqiten me vëllim të gjerë konceptor. "...këto terma kanë dy ose (rrallë) më shumë brendi konceptore dhe secila brendi, duke pasur një vëllim pak a shumë të gjerë konceptor, përfshin brenda saj koncepte me vëllim të gjerë konceptor."⁴ Kështu termi *energji* haset si term me ngarkesë të lartë konceptore kur përdoret me shpjegimin e dhënë në FGJSSh 1980, në kuptimin e dytë të tij: *2. fiz. Aftësia që ka një trup a një lëndë për të bërë një punë të caktuar ose për të qenë burim i një force që vë në lëvizje a në veprim diçka.*

Duke u zgjeruar në togfjalësha dygjymtyrësh (më rrallë në më shumë se dy gjymtyrësh), koncepti vjen e ngushtohet p.sh. *energji termike e trupit* (F.9), *energji kinetike e lëvizjes tejbartëse* (F. 10) etj. Vërejmë se duke kaluar nga klasa në klasë, ngritja e vetëdijes gjuhësore të nxënësve, rritja e aftësive perceptuese e abstraguese të tyre, bëjnë që sistemi terminologjik shkencor të rritet në numër me terma togfjalësh. Në tekstin e abetares, klasa e parë, hasen 12 terma njëfjalësh dhe vetëm dy terma dyfjalësh: *shkronjë, rrokje, tingull* etj. dhe *fjalë njërrrokëshe* dhe *fjalë dyrrrokëshe*. Në tekstin e gjuhës shqipe të klasës së dytë, terminologjia gjuhësore përbëhet nga 10 njësi leksikore njëfjalëshe dhe 7 njësi leksikore dyfjalëshe. Në tekstin e gjuhës shqipe të klasës së tretë gjejmë 20 terma njëfjalësh dhe 28 terma dyfjalësh; në tekstin e klasës së gjashtë kemi 24 terma njëfjalësh, 49 terma dyfjalësh, 11 terma trifjalësh dhe 4 terma mbi trifjalësh, p.sh., *dhënësi, marrësi, komunikim gjuhësor, temë fjalëformuese, fjali e përbërë me nënrenditje, fjali e përbërë me bashkërenditje kundërshtuese* etj.

Përgjithësisht termat njëfjalësh përbëjnë termat bazë të çdo terminologjie shkencore. Tekstet e klasave të ulëta të ciklit 9-vjeçar përmbajnë nocinet më të qenësishme për shkencat përkatëse, ngarkesën kryesore të informacionit shkencor-teknik. Kështu gjejnë përdorim të gjerë njësitë terminologjike: *mbledhje, zbritje* etj. (M. 2), *drejtëz, segment, shumëkëndësh* etj. (M. 3), *numërorë, kënd, thyesë* etj. (M. 4); *fjalë, shkronjë, rrokje* (abetare), *fjali, emër, mbiemër, pikë* etj. (GJ. 2), *kryefjalë, ndajfolje, parashtesë* etj. (GJ. 3); *trup, gaz, vëllim, busull* etj. (D. N. 3), *gjithësi, planet, kontinent, vargmal* etj. (D. N. 5); *biosferë, habitat, ndotje, biomasë* etj. (B. 6) *klasifikim, kërpudhë, likene* etj. (B. 8); *trup, lëndë, rëndesë, masë* etj. (F. 6); *lëvizje, prehje, shpejtësi* etj. (F. 7). Të tilla njësi terminologjike njëfjalëshe, duke qenë themeli i nënsistemeve terminologjike, funksionojnë si bazë për formimin e togfjalëshave terminologjike duke shërbyer njëherazi si elemente termformuese dhe konceptformuese, si: *emër- emër i përgjithshëm, emër i dygjinishëm, sistem emëror; folje- folje kalimtare, folje pavetore, grup foljor; fjali- fjali dëftore,*

⁴ A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 99.

ffjali njëkryegjymtyrëshe emërore; shpejtësi- shpejtësi mesatare, shpejtësi e trupit etj.

2. Struktura morfologjike e termave njëfjalësh në tekstet mësimore të APU-së

Siç dihet, çdo term përfaqëson në vetvete një shenjë që i përgjigjet një koncepti. Tërësia e koncepteve të një fushe të caktuar të dijes përbën sistemin e koncepteve të asaj fushe. Në këtë sistem konceptesh dallohen koncepte kryesore, parësore e të derivuara. Struktura e termave kushtëzohet nga karakteri i koncepteve. Në strukturën e tyre termat dalin si fjalë të thjeshta, të prejardhura, të përbëra dhe togfjalësha.

Nga pikëpamja e numrit të morfemave rrënjore që mund të kenë, fjalë-termat ndahen në dy grupe të mëdha:

1. Fjalë-terma të thjeshtë që kanë vetëm një morfemë rrënjore. Të tilla janë: *fjalë, ffjali, emër, mbiemër, frymor, folje, zgjedhim* (Gj. 2); *rrethanor* (Gj. 4); *përcaktor* (Gj. 5); *i përveçëm, konkret, lidhëz, prejardhje* (Gj. 6); *toskërishte, mbaresë* (Gj. 7); *yll, yllësi, rrotullim, eklips, paralel, liqen, akullnajë, akullzim, erë, lumë, erozion, ekuinoks* (Shk. T. 1); *drejtëz* (M. 3); *zbritje* (M. 2); *rrumbullakim, thyesë* (M. 3); *mesore, simetrikë, barazim, mosbarazim* (M. 7); *vëllim, rreth, tangjente* (M. 8); *masë, tkurrje* (F. 6); *lëvizje, forcë, amplitudë, përhapet* (F. 7); *frekuencë, përcjellës, veçues, nxitim, shformim* (F. 8); *qelizë, ind, organ, kërcell, gjethe, lule, bimë* (D. N. 4); *bërthamë, bërthamëz, vezore* (B. 8); *venë, kapilarë, pllenim* (B. 9) etj.

2. Fjalë-terma të përbërë të cilët kanë dy ose më shumë morfema rrënjore. Të tilla janë: *drejtshkrim* (Gj. 2); *pikëpresje* (Gj. 5); *gjysmëdrejtëz* (M. 3); *shumëfaqësh* (M. 4); *jashtëqendërsi* (M. 8); *gjithçkangrënës, dythelbore* (D. N. 4); *vetushqyese* (D. N. 5); *elektrovalencë* (K. 7); *grykëderdhje* (Gjeo. 6); *vargmal* (Shk. T. 1) etj.

Të vështruar nga pikëpamja e fjalëformimit, sipas karakterit të temës, termat e leksikut terminologjik të teksteve mësimore, ndahen në:

a) fjalë-terma të përbërë, p.sh.: *rrënjë, temë, emër, trajtë, nyjë* etj., gjuh.; *ajër, mot, lagunë, lumë, erë, re, mjegull* etj., gjeografi; *trup, lëndë, fuqi, qark, gaz, tingull* etj., fiz.; *lule, farë, syth, bimë, gjak* etj., bio.; *rreze, numër, bosht, element, shumë* etj., mat.

b) fjalë-terma jo të përbërë, p.sh.: *frymor, numëror, parashtesë, prapashtesë, rrethanor, përcaktor, kallëzues, lidhëz* etj., gjuh.; *rrotullim, gjatësi, gjerësi, akullzim, ranorë, gëlqerorë, sulfaturë, fosilizim* etj., gjeog.; *bumim, lëngëzim, shformim, shëmbëllim, lëvizje, prehje, përcjellshmëri, nxehtësi* etj., fiz.; *pjesëtim, rrumbullakim, drejtëz, sipërfaqe, veprim, emërues, numërues, lakore, veçim, barazi* etj. mat.

Një grup më vete krijojnë termat që dalin si simbole të disa madhësive fizike si dhe të përbërjeve kimike që përfaqësohen nga një shkronjë, p.sh., *S* (rruga), *F + N* (forca), *G* (forca e rëndesës), *A* (puna) etj., fiz.; nomenklaturë e

kimisë, si: *H* (hidrogjen), *C* (karbon), *B* (bor), *P* (fosfor), *S* (squfuri), *O* (oksigjeni), *N* (azoti) etj.

3. Klasifikimi i termave njëfjalësh sipas pjesëve të ligjëratës

Në rrafshin logjik, në dallim nga fjala e përgjithshme e cila lidhet me kuptimin, termi është njësi emërtuese që shpreh lidhjen mes konceptit dhe objektit, lidhjen e formës me përmbajtjen. Ndërsa e parë në rrafshin gjuhësor, termi është emërtimi i konceptit (që në vetvete përmban lidhjen koncept-objekt). Përgjithësisht në letërsinë terminologjike, në fjalorët terminologjikë, si terma pranohen njësi emërtuese emërore. Njësitë që shprehin koncepte shkencore, por që dalin si pjesë të tjera ligjërate përveç emrit të tilla si folje, mbiemra apo ndajfolje, nuk gjejnë pasqyrim (ose e gjejnë të kufizuar) ndër shumicën e fjalorëve terminologjikë. Kjo është një çështje që ende nuk ka gjetur një zgjidhje të normativizuar dhe që përbën një problem me karakter teorik dhe më së shumti praktik.

Kuptimi i përgjithshëm kategorial i klasës së mbiemrave është tipari i kuptuar si cilësi, veti a marrëdhënie dalluese. Nga ana kuptimore mbiemrat përfshihen te fjalët emërtuese, te fjalët kuptimplota, që shprehin koncepte. Pavarësia e mbiemrave është relative meqë "...mbiemrat emërtojnë tiparin si diçka që i përket një sendi të dhënë, prandaj në fjali ata ndodhen në lidhje të ngushtë gramatikore me emrin që emërtojnë."⁵ Por, për ne, klasifikimi i mbiemrave si fjalë emërtuese konceptshënuese, u jep të drejtën të përfshihen në fjalësin terminologjik. Sipas së njëjtës logjikë gjykojmë, që folja duhet të përfshihet në sistemin emërtues terminologjik. Si fjalë emërtuese, folja emërton veprime, procese a gjendje. Veprimet, proceset apo gjendjet e emërtuara nga folja janë të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorë me një kohë të caktuar. Ky është një nga tiparet kryesore që e dallon atë nga veprimet, proceset dhe gjendjet e emërtuara nga emrat.

Në terminologjinë shkollore të teksteve të APU, në vijën logjike dhe vijueshmërinë rendore të koncepteve, nxënësit njihen me termin *zgjedhoj* (Gj. 2), përpara se të njihen me termin *zgjedhim* (Gj. 3).

Duke u mbështetur në kushtet që e bëjnë një term pjesë të një sistemi të caktuar terminologjik⁶, pjesët e ligjëratës, si foljet dhe mbiemrat mund të dalin si terma, kur në to ndihet në mënyrë të qartë lidhja e tyre pas një fushe dhe kuptimi të vetëm...⁷ Ndaj dhe në klasifikimin e termave sipas pjesëve të ligjëratës, ne do të përfshijmë edhe termat folje e mbiemra, duke i parë si njësi terminologjike të motivuara si nga ana fjalëformuese ashtu edhe konceptore në

⁵ Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f. 153.

⁶ A. Duro, *Fjala –term dhe struktura semantike e fjalës shqipe*, SF, 1991, 3-4, f. 139-156. (Për autorin kushtet që e bëjnë një term pjesë të një sistemi terminologjik janë: kuptimi, fusha e përdorimit, vlera dhe rëndësia e përdorimit dhe aftësia termformuese.)

⁷ Po aty, f. 149.

mënyrë të drejtpërdrejtë me termat emra, p.sh., *lako* → *lakim* → *i lakueshëm*, *pjesëtoj* → *pjesëtim* → *i pjesëtueshëm*, *tret* → *tretje* → *i tretshëm* → *tretshmëri* etj. Gjykojmë që njësitë terminologjike foljore dhe mbiemërore tek të cilët ndjehet qartë lidhja pas një fushe dijeje dhe një kuptimi të vetëm, mund ta kryejnë rolin e termit po aq sa dhe njësitë emërore.

1. Terma emra: *fjalë*, *shkronjë*, *emër*, *përemër*, *folje*, *antonim*, *kryefjalë*, *zgjedhim*, *dialekt*, *presje*, *rasë*, *frazeologji*, *temë*, *remë* etj., gjuh.; *fabul*, *strofë*, *personazh*, *dramë*, *antitezë*, *ese*, *simbol*, *metaforë* etj., let.; *faktor*, *rrumbullakim*, *emërues*, *rreth*, *trapez*, *ekuacion*, *koordinatë*, *prodhim*, *kufizë*, *mosbarazim*, *teoremë* etj., mat.; *sjellje*, *ankth*, *qëndrim*, *konflikt* etj., psik.; *trup*, *lëndë*, *bymim*, *rëndesë*, *masë*, *lëvizje*, *prehje*, *valë* etj., fiz.; *bimë*, *rrënjë*, *ind*, *qelizë*, *sheqerna*, *amidon*, *klorofil* etj., biol.; *shkretëtirë*, *tajfun*, *reliev*, *hemisferë*, *hartë*, *pellg*, *shkëmb*, *kontinent* etj., gjeog.

Terminologjia e teksteve të APU është e pasur me terma –emra abstraktë. Emrat abstraktë janë përfitime më të vona në gjuhë, siç janë të vona konceptet abstrakte në procesin e njohjes dhe të pasqyrimin të botës. Çdo perceptim i cilësive dhe veprimeve konkrete mban në vetvete mundësinë e abstragimit.⁸ Vlera përdorimore e termave abstraktë në tekstet mësimore të APU lidhet me zhvillimin e mendimit shkencor, me nevojën për të shprehur koncepte abstrakte në fusha të ndryshme të dijes dhe me mundësitë për t'i shprehur ato me mjete gjuhësore sa më të përpikta e të kursyera.

Emra abstraktë që emërtojnë veprime ose gjendje: *zgjedhim*, *lakim*, *emërzim*, *ndajshim* etj., gjuh.; *shumëzim*, *prodhim*, *barazim*, *mosbarazim*, *shndërrim*, *çiftim*, *pohim* etj., mat.; *shformim*, *ngurtësim*, *magnetizim*, *fërkim*, *nxitim*, *rrezatim* etj., fiz.; *fekondim*, *shumim*, *ovulim*, *kryqëzim*, *tejçim* etj., biol.; *kënetëzim*, *migrim* etj., gjeog.; *përqendrim*, *shpërbashkim*, *eliminim*, *esterifikim*, *filtrim* etj., kim.

Një grup më vete përbëjnë emrat abstraktë të veprimit në gjininë femërore: *përshtatje* gjuh.; *zgjidhje*, *rrumbullakosje* mat.; *zhvendosje*, *lëvizje* fiz.; *rritje*, *jashtëqitje*, *përshtatje*, *parapërshtatje*, *ripërtëritje* etj., biol.

Hasen gjithashtu edhe terma-emra që tregojnë rezultatin e veprimit, si: *drejtshkrim*, *vërtetim*, *përkufizim*, *shëmbëllim* etj. apo edhe të gjinisë femërore si: *mbetje*, *shkrirje* etj. Në këtë grup përfshihen edhe emrat abstraktë: *mbaresë*, *shkurtesë* gjuh., *ndryshesë*, *largesë* mat., *rëndesë* fiz., *tretësirë* kim., *kujtësë* psik. etj.

Në terminologjinë e hulumtuar dalin në një numër të vogël si terma edhe emra prejfoljorë të paranyjzuar, si: *të shikuarit*, *të dëgjuarit*, *të shkruarit*, *të lexuarit*, *i shenjuari* në gjuhësi, *të nuhaturit*, *të shikuarit*, *të shijuarit*, *të prekurit*, *të kequshqyerit*, *të mbiushqyerit* në biologji, *të mësuarit* në psikologji.

⁸ E. Teichmann, *Hapa në universin e ligjërit*, Tiranë, 2010, f. 90.

2. Një kategori gramatikore që përdoret gjerësisht në terminologjinë shkollore është kategoria e mbiemrave. Në gjuhën shqipe mbiemri i krijuar nga një emër konkret ka një kuptim më special se emri nga i cili buron. “Mbiemrat janë një kategori shumë e nevojshme për emërtimet terminologjike, ku shkurtësia është një ndër kërkesat themelore, krahas nevojës për të shprehur nuanca të ndryshme kuptimore që realizohen me prapashitesa të ndryshme...”⁹

Për nga struktura e tyre morfologjike, termat- mbiemra dalin:

a) të nyjshëm, si: *i përveçëm* (Gj. 3); *i përbërë* (Gj. 4); *i ndryshueshëm* (Gj. 5); *i ngurtë*, *i gaztë*, *i lëngët* (F. 6); *e njëtrajtshme* (F. 8); *i tretshëm*, *i patretshëm* (K. 9) etj.

b) të panyjshëm, si: *konkret*, *abstrakt* (Gj. 4); *pësor*, *vepror* (Gj. 7); *qelizor*, *shumëqelizor* (B. 7); *enëzor*, *nervor*, *muskulor* (B. 11); *trashëguese*, *kanceroze*, *ndjesore*, *lëvizore*, *embrionale* (B. 9); *epitelial*, *seksual*, *aseksual* (B. 10); *naturor*, *racionalë* (M. 5); *vertikale*, *horizontale* (M. 6); *kongruentë*, *simetrikë* (M. 7); *bërthamore* (F. 8); *elektrike*, *akustike* (F. 11); *kinetike* (F. 10); *oqeanik*, *malor*, *ekologjik*, *sipërfaqësor*, *detare*, *ishullor* (Gjeo. 6) etj.

Vërejmë se në tekstet mësimore gjejnë përdorim më të dendur termat mbiemra të panyjshëm. Në veçanti, termat mbiemra që janë pjesë e nënsistemit terminologjik të biologjisë dalin kryesisht si mbiemra të panyjshëm.

3. Siç e thamë edhe më lart, në klasifikimin strukturor të terminologjisë shkencore në tekstet mësimore do të pasqyrojmë edhe termat folje, edhe pse këta përfshihen jo në mënyrë të njëjtësuar në fjalorët terminologjikë.

Si terma folje që shprehin koncepte të derivuara dalin: *zgjedhoj* (Gj. 2); *lako* (Gj. 3); *shqiptoj* (abeta); *komuniko* (Gj. 6); *përshat(et)* (Gj. 4); *emërzoj* (Gj. 8); *zgjeroj* (Gj. 5); *grupoj* (M. 2); *shoqëroj* (M. 2); *pjesëtoj*, *plotpjesëtoj* (M. 3) *mbledh*, *zbres*, *zmadhoj*, *zvogëloj* (M. 1); *thyj(het)*, *përhap(et)* (F. 11); *shformoj(het)* (F. 7), *jonizoj* (F. 8); *fundërroj(n)*, *tret* (K. 7); *shpërbëj(het)*, *shpërbashkoj(het)* (K. 8) etj.

Terma folje gjejnë përdorimin e tyre më të zakonshëm në vetën e tretë njëjës, më rrallë në shumës, një pjesë e mirë e tyre në formë joveprore.

4. Terma të përbërë, të cilët kanë dy ose më shumë morfema rrënjore. Përdorimi i fjalëve të përbëra¹⁰ është një nga rrugët kryesore të shqipërimit të

⁹ F. Leka, *Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko-shkencore pas Çlirimit*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Tiranë, 1972, f. 199.

¹⁰ E përdorim temin *fjalë të përbëra* në përputhje me përdorimin e rëndomtë të tij, pasi duke u nisur nga mënyra e formimit të këtyre fjalëve në shqipen e sotme, është më e saktë të flasim për *përbërje të temave*. Shih më gjerë A. Kostallarin në “*Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*”, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972, f. 83.

termave në gjuhën shqipe. Krijimi i termave me fjalë të përbëra në gjuhën shqipe merr vlerë përdorimore, pasi të tillë terma bartin në vetvete edhe një farë shpjegimi fillestar të përmbajtjes së konceptit, duke përfshirë kuptimshmëri të lartë. Fjalët e përbëra, duke pasur të paktën dy tema motivuese, kanë zakonisht një ngarkesë semantike më të madhe se fjalët e prejardhura dhe e paraqesin më qartë e në mënyrë më të drejtpërdrejtë konceptin që shprehin, prandaj ato kanë përhapje të gjerë, sidomos në terminologjinë tekniko-shkencore, ku kërkohet një shprehje sa më e përpiktë dhe njëkohësisht sa më ekonomike. Me anë të përbërjes krijohen terma të rinj të motivuar që dalin të kuptueshëm dhe të pranueshëm. Duke iu përshtatur rregullave të fjalëformimit, një pjesë e mirë e termave janë shqipërime të pjesëve përbërëse të fjalëve të huaja nga është përcjellë koncepti a objekti. Në tekstet mësimore dalin fjalë-terma të përbërë, p.sh., *fjalëformim*, *pikëpyetje*, *pikëçuditje*, *shumëpikësh* etj. (gjuh.); *trekëndësh*, *katërkëndësh*, *vlerëplotë* etj. (mat.); *elektroasnjanim*, *barazpeshë* etj. (fiz.); *frymëmarrje*, *frymëkëmbim*, *njëthelbore*, *dëmtuesvrasës*, *lëkurëgjemborë*, *biomasë*, *ekosistem*, *rrethlule*, *qelizadjegës*, *dykapakorë*, *këmbënyjtuar*, *jetërushqyes*, *ozmozëdashës* etj. (biol.); *elektrovalencë*, *kripëformues*, *elektronegativitet* etj. (kim.); *grykëderdhje*, *fushëgropë*, *rrafshnaltë* etj. (gjeog.).

4. Termi togfjalësh në tekstet mësimore të APU-së

Për të emërtuar objekte dhe koncepte të reja (për të shqipëruar termin e huaj të pranishëm bashkë me objektin, dukurinë a konceptin) që bëhen pjesë e shkencës dhe teknologjisë së përditësuar, shfrytëzohen mjetet shprehëse të gjuhës. Jo rrallë është i pamundur emërtimi i një koncepti me një fjalë të vetme. Saktësia dhe qartësia e shprehjes së konceptit, ruajtja e pastërtisë së gjuhës shqipe, kushtëzon shpeshherë emërtimin e tij me njësi gjuhësore më të zgjeruara se një fjalë e vetme, që janë termat togfjalësha. Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë¹¹, togfjalëshat e zgjeruar¹² janë një nga mënyrat më prodhimore të termformimit në gjuhën shqipe.

Për terminologun Agron Duro, "...togfjalëshi i qëndrueshëm terminologjik është njësi e mëvetësishme leksiko-sintaksore, i cili duke qenë funksionalisht barazvlerës i fjalës, shërben për të shënuar, si edhe fjala, objekte ose dukuri të vetme të realitetit objektiv."¹³ Pra, nga ana semantike, të tilla njësi emërtuese janë të njëvlershme me një fjalë të vetme, me një koncept të vetëm, ndërsa nga këndvështrimi sintaksor janë lidhje sintagmatike dy ose më shumë fjalëshe.

¹¹ A. Duro, *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme*, në "Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", Tiranë, 1989, f. 665.

¹² H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 122.

¹³ A. Duro, *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme*, në "Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III", Tiranë, 1989, f. 674.

Përcaktimi i tipareve të togfjalëshit terminologjik, identifikon dhe diferencon këtë njësi shënuese konceptore nga togfjalëshat e lirë. Si veçori të qenësishme të termit shumëfjalësh do të rendisnim:

a. Vlera funksionore që përcaktohet nga njëvlershmëria e tij me një koncept të vetëm.

b. Përkatësia në një sistem konceptor. Lidhjet sistemore ndërmjet termave, kanë si bazë fillestare jo afërsinë apo njëvlerësinë kuptimore, pra kuptimin si kategori gjuhësore, por konceptin si kategori logjike. Kështu, njëri nga konceptet, ai më i përgjithshmi, shërben për të lidhur mes tyre konceptet e tjera, duke krijuar në këtë mënyrë një mikrosistem brenda fushës së dijes. Kështu, termi dyfjalësh *mbiemër i nyjshëm* i përket sistemit terminologjik të gjuhësisë dhe përvijon lidhje konceptore, sistemore e varësie me termat *mbiemër i panyjshëm, emërzim i mbiemrit, mbiemërzim* etj.

c. Lidhja e qëndrueshme e gjymtyrëve të togfjalëshit terminologjik. Kjo qëndrueshmëri kushtëzohet nga lidhja mes objekteve, dukurive apo koncepteve. Kjo lidhje "zbeh" semantikën e veçantë të gjymtyrëve përbërëse, për ta rikuptimësuar, për ta riemërtuar lidhjen e tyre përmes unitetit semantik gjymtyror.

d. Prania e më shumë se një njësie emërtuese. Kur flasim për togfjalësh të lirë, numri i gjymtyrëve të tij bën dallimin në togfjalësh të thjeshtë dhe togfjalësh të zgjeruar: "...togfjalësha të thjeshtë të sajuar prej dy fjalësh kuptimplota me ose pa fjalë shërbyese. *Togfjalëshat e zgjeruar* janë sajuar ose prej një fjale kuptimplotë dhe prej një togfjalëshi ose prej dy togfjalëshash."¹⁴ Ndërsa në studimet mbi togfjalëshin terminologjik, mbahen qëndrime të ndryshme rreth numrit të gjymtyrëve të togfjalëshave të tillë. H. Pasho pranon terma togfjalëshat të zgjeruar me 3-6 përbërës. "..., me zgjerimin e përmbajtjes së koncepteve e të lidhjeve ndërmjet tyre dhe me kërkesën për një saktësi sa më të madhe të emërtimit të tyre, të nuancave konceptore që janë aq të domosdoshme për terminologjinë, janë të domosdoshëm edhe togfjalëshat e zgjeruar."¹⁵ Për A. Duron termi dyfjalësh shenjon më së miri njësinë logjiko-konceptore; termi togfjalësh me më shumë se dy përbërës që zgjerohet me disa bërthama, zgjeron shumë kufijtë e togfjalëshave terminologjike dhe çon në përzierjen e kufijve të togfjalëshave të qëndrueshëm me togfjalëshat e lirë, në nivelin e shprehjeve terminologjike ose të gjysmëpërkufizimeve. Gjykojmë që numri i kufizuar i përbërësve të togfjalëshit terminologjik ruan lidhjen e qëndrueshme të përbërësve, duke realizuar më qartë shenjimin e konceptit.

¹⁴ ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 2002, f. 82.

¹⁵ H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 124.

“Njësimi semantik, shënimi i një koncepti, duhet të jetë kriteri që organizon dhe strukturën e këtyre termave togfjalësha.”¹⁶

5. Klasifikimi i termave togfjalësha sipas rrafshit strukturor

Për nga struktura sintaksore termat togfjalësha ndahen në: *terma togfjalësha të thjeshtë* dhe në *terma togfjalësha të zgjeruar*.

Terma togfjalësh të thjeshtë janë terma të përbërë nga dy fjalë shënuese. Këta togfjalësha terminologjike krijojnë një lidhje të brendshme konceptore ndërmjet elementeve përbërëse për të shprehur një koncept të vetëm. Nga këta dy përbërës, njëri është termi bazë, që shpreh konceptin themelor (gjymtyra e përcaktuar) dhe përbërësi i dytë është elementi përcaktues. Marrëdhëniet mes dy gjymtyrëve të togfjalëshit terminologjik sigurojnë karakterin e njësuar kuptimor dhe gramatikor të njësisë emërtuese. Zgjerimi i strukturës së termit nga njëfjalësh në dyfjalësh, çon në shtim të vëllimit konceptor të termit bazë, duke dhënë një koncept të ri. Koncepti i ri që rezulton nga lidhja konceptore e elementeve përbërëse, kushtëzohet nga konceptet e gjymtyrëve të lidhjes dhe marrëdhënia që ekziston ndërmjet tyre. Marrëdhëniet ndërmjet termave shihen kështu si marrëdhënie ndërmjet koncepteve, të cilat ndërtohen në bazë të lidhjeve të ndryshme logjike. Mes elementeve përcaktuese dhe konceptit themelor shprehen marrëdhënie të derivuara konceptore.

Përdorimi i togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjike me dy përbërës është zgjedhje e volitshme në terminologjinë shkencore në përgjithësi dhe në tekstet mësimore në veçanti. Përparësia e termit togfjalësh ndaj atij njëfjalësh, shfaqet në vetinë e njëkuptimësisë që fiton termi togfjalësh edhe jashtë fushës së vet. Pjesa më e madhe e termave të vjelë nga tekstet në shqyrtim, janë terma dyfjalësh: *shenjë pikësimi* (Gj. 3), *kategoria e rasës* (Gj. 6), *fjali dëftore* (Gj. 3), *fjalë të mëvetësishme* (Gj. 8); *veti e ndërrimit* (M. 2), *thyesë dhjetore* (M. 5); *fshikëza e notimit* (B. 8), *pllenim i brendshëm* (B. 8); *shëmbëllim i trupit* (F. 7), *baraspeshë termike* (F. 6); *pika të horizontit* (Shk. T. 1), *agim polar* (Gjeo. 6); *ndërtim i atomit* (K. 7), *element kimik* (K. 8) etj.

Vështuar nga ana e strukturës morfologjike sipas përbërësve, togfjalëshat e thjeshtë terminologjike janë kryesisht togfjalësha emërorë; më të rrallë janë togfjalëshat foljorë. Togfjalëshat e thjeshtë emërorë janë të tipit *emër + emër*, *emër + mbiemër* dhe më rrallë *emër + paraafjalë + emër*.

1. Përhapje të gjerë kanë togfjalëshat *emër + emër i shquar në gjinore*. Kjo strukturë kombinuese është e pëlqyeshme në krijimin e togfjalëshave terminologjike, pasi emri i shquar tregon një farë pavarësie semantike, d.m.th., ai ka kuptimin gramatikor të tregimit të sendit¹⁷. *grupi i kryefjalës* (Gj. 3); *kategoria e rasës* (Gj. 6); *marrëdhënie të barazisë* (Gj. 7); *qendër e rrethit* (M.

¹⁶V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 153.

¹⁷ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 2002, f. 89.

4); *vëllim i trupit* (M. 5); *fshikëz e notimit* (B. 8); *cikli i azotit* (B. 11); *forcë e rëndesës* (F. 7); *shpejtësi e trupit* (F. 7); *ndërtim i atomit* (K. 7); *shkallë e pangopshmërisë* (K. 9); *pikat e horizontit, kurba e relievit* (Shk. T. 1) etj.

2. Më të paktë në numër hasen togfjalëshat terminologjikë *emër + emër i pashquar në rrjedhore*. Duke dalë si fjalë përcaktuese, emri në rrjedhore afrohet nga kuptimi me mbiemrin cilësor dhe lidhet ngushtë me të nga pikëpamja semantike. Rrjedhorja në ndërtime të tilla del si përcaktor i abstraguar. Këta togfjalësha shprehin marrëdhënie të llojit në lidhje me gjininë, përkatësi, destinacion. *grup fjalësh* (Gj. 2); *shenjë pikësimi* (Gj. 3); *etalpi reaksioni* (K. 9); *numër oksidimi* (K. 9); *trup rrotullimi* (M. 4); *funksioni fuqi* (M. 4. 1); *bashkësi yjesh* (Gjeo. 6); *periodë qarkullimi, bërthamë kondensimi* (Shk. T. 1) etj.

3. Edhe më të paktë në numër dalin togfjalëshat terminologjikë të tipit *emër + parafjalë + emër: prejardhje me parashtesa* (Gj. 6); *kënd në rreth* (M. 6); *faza me dritë* (B. 9); *lidhje në seri* (F. 6); *vullkan me mburojë* (Shk. T. 1) etj.

Nga analiza e termave shkencorë që dalin në tekstet mësimore të APU-së, kemi vënë re se, me gjithë praninë e larmishme të togfjalëshave emërorë me përbërës të dytë një emër, në këtë leksik ndërterminologjik mbizotërojnë togfjalëshat emërorë ku fjala përcaktuese është një mbiemër. “Prireja e përgjithshme drejt sintetizmit vihet re edhe në formimin e togfjalëshave ku parapëlqehet që përbërësi i dytë në togfjalëshin e thjeshtë të jetë më mirë mbiemër se sa emër në gjinore ose emër me parafjalë.”¹⁸ *shprehje frazeologjike* (Gj. 3); *gjini gramatikore* (Gj. 6); *trekëndësh këndrejtë* (M. 6); *numër racional* (M. 7); *ind kockor* (B. 7); *ndarje qelizore* (B. 12); *element kimik* (K. 7); *përbërje jonike* (K. 7); *rrymë oqeanike* (Gjeo. 6); *stacion meteorologjik* (Gjeo. 6) etj.

6. Togfjalësha të zgjeruar terminologjikë

Terma togfjalësh të zgjeruar janë terma të përbërë nga më shumë se dy fjalë shënuese. Edhe pse me më shumë se një gjymtyrë, kriteri i njësimiit semantik u jep këtyre togfjalëshave njëvlerësinë e termit që emërton një koncept të vetëm. Marrëdhëniet mes dy gjymtyrëve të togfjalëshit terminologjik sigurojnë karakterin e njësuar kuptimor dhe gramatikor të njësisë emërtuese. Zgjerimi i strukturës së termit sjell shtim të vëllimit konceptor të termit bazë, duke dhënë një koncept të ri. Koncepti i ri që rezulton nga lidhja konceptore e elementeve përbërëse, kushtëzohet nga konceptet e gjymtyrëve të lidhjes dhe marrëdhënia që ekziston ndërmjet tyre.

Në terminologjinë e shkencës e teknikës të teksteve mësimore janë të paktë togfjalëshat e zgjeruar terminologjikë. Gjejmë togfjalësha me tre

¹⁸H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe*, Tiranë 2005, f. 123.

Termi njëfjalësh dhe termi togfjalësh në tekstet mësimore të arsimit...

përbërës, një numër më të paktë togfjalëshash me katër përbërës (në literaturën e vjelë kemi gjetur togfjalësha të zgjeruar deri me pesë përbërës, të cilët janë shumë të paktë): *pjesë kryesore e fjalisë* (Gj. 3); *grupi foljor i kallëzuesit* (Gj. 4); *bosht i madh i elipsës* (M. 11); *sistem kartezian normal* (M. 4.1) *emëruesi më i vogël i përbashkët* (M. 5); *bimë me gjelbërim të përhershëm* (D. N. 3); *energji e ujërave nëntokësore, burime drite natyrore* (D. N. 4); *pyje përherë të gjelbërta* (B. 6); *reaksion bërthamor endoenergjitik* (F. 11); *forcë e bashkëveprimit ndërmolekular* (K. 11) etj.

Për nga ana e strukturës morfologjike, togfjalëshat e tipit të mësipërm janë ndërtime me modele të larmishme. Përbërësit janë emra: gjymtyra e përcaktuar është në rasën emërore, ndërsa gjymtyrët përcaktuese mund të jenë emra të rasës gjinore, në rasën kallëzore me parafjalë (kryesisht del parafjala *me*), emra në rasën rrjedhore, mbiemra, ndajfolje: *emër i gjinisë mashkullore* (Gj. 2); *fjalë me kuptim të figurshëm* (Gj. 4); *shkëmbinj magnetikë intrusivë* (Shk.T.1); *ekosistem pjesërisht bujqësor i kultivuar* (Gjeo. 6) etj.

